



Rreth 59 mijë fermerë të mbështetur nga Skema Kombëtare e Bujqësisë

Faqe 2



Pogradeci rikthen në jetë varietetet autoktone të rrushit

Faqe 2



2.4 milionë euro për sigurinë ndaj pesticideve - Nga viti 2026 nis projekti i ri për fuqizimin e laboratorëve në ISUV

Faqe 2



AGROBIZNESI

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit dhjetor 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 523
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

MINISTRIA E BUJQËSISË, UNIDO DHE SECO FORCOJNË THEMELET E QASJES LEADER DHE PËRGATISIN TERRITORET PËR FONDET E BE-SË NË SHQIPËRI

PROCESI I REGJISTRIMIT TË GVV-EVE DHE SHKËMBIMET ME HOMOLOGËT ITALIANË PO KRIJOJNË NJË MODEL TË RI ZHVILLIMI RURAL TË ORIENTUAR NGA KOMUNITETI, DUKE KONSOLIDUAR BAZAT PËR QEVERISJE TË QËNDRUESHME, KOORDINIM INSTITUCIONAL DHE AKSES EFEKTIV NË FONDET E BASHKIMIT EVROPIAN

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

ALBANIA

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



INVESTIME NË AGROTURIZËM

Demo: 40 bashki përzgjedhin zonat prioritare për Paketën e Maleve, në 2026 nisin investimet e para

Faqe 5

TEMA TË DITËS

- Shirat pengojnë mbjelljet në Përmet - Sipërfaqet e kultivuara përgjysmohen Fq.2
- 32 vite përkushtim në blegtori - Asim Banushaj vazhdon traditën familjare Fq.4
- Shqipëria, pjesëmarrëse në asamblenë e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit në Spanjë Fq.5
- Pas 30 vitesh largimi dhe punë në Evropë, Kitmir Jeminaj rikthehet në Kukës për të vazhduar zanatin e furrtarit Fq.5
- Siguria e ullishtave, ekspertët shqiptarë në takimin rajonal në Itali Fq.6
- Biomimetika në Arkitekturë dhe Planifikimin Urban - Prof. As. Dr. Eqrem & Ema Meçollari Fq.13

Faqe 4

Bido: Sulm i padrejtë ndaj mandarinave të Konispolit, dëmshpërblejmë fermerët për përmbytjet



Faqe 10

FED INVEST

Tregu i shoqërive të kursim-kreditit në rritje vjetore



Faqe 10

TEMA TË DITËS

Pogradeci rikthen në jetë varietetet autoktone të rrushit

Pogradeci po rikthen në jetë varietetet autoktone të rrushit si Muskat Kanell, Gëms dhe veçanërisht Serina e Bardhë, falë projektit Typic-al, një pro-

Kryetari i Bashkisë së Pogradecit, Ilir Xhakolli tha se, përveç identifikimit dhe ruajtjes së varieteteve tradicionale të rrushit, projekti ka përfshirë

Sipas tij, në kuadër të projektit është mbështetur krijimi i një strukture të re bashkëpunimi mes fermerëve, përmes shoqërive bujqësore, duke ndihmuar në uljen e kostove të prodhimit, ndarjen e teknologjisë së avancuar dhe përfitimim nga trajnimet profesionale të ofruara nga ekspertët e CIHEAM Bari dhe MBZHR.

Përfitimet për komunitetin rural janë të dukshme: rritje e prodhimit të rrushit autokton, rikthim i kultivimit të varieteteve të rralla, akses më i mirë në treg, rritje të të ardhurave dhe krijim i mundësive të reja për punësim në sektorin bujqësor dhe atë të agro-përpunimit.

Ky projekt përfaqëson një shembull të bashkëpunimit të suksesshëm midis institucioneve shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë. Bashkëpunimi Italian, CIHEAM Bari dhe Ministria e Bujqësisë riafirmojnë përkushtimin për të mbështetur fermerët e Pogradecit, për të ruajtur biodiversitetin dhe për të zhvilluar një bujqësi më të qëndrueshme dhe konkurruese.

Në këtë kuadër, krijimi i SHBB Grabovicë dhe bashkimi i fermerëve vlerësohet si një hap i parë i rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve të prodhuesve lokalë. Sipas përfaqësuesve të projektit, vetëm përmes bashkëpunimit fermerët mund të përfitojnë më shumë nga programet e BE-së dhe projektet e mbështetura nga qeveria shqiptare.



gram i financuar nga Qeveria Italiane përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), i zbatuar nga CIHEAM Bari në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

edhe financimin e blerjes së makinerive bujqësore moderne dhe pajisjeve teknologjike, të cilat u japin fermerëve mundësi të punojnë me mjete më efikase dhe sipas standardeve europiane.

2.4 milionë euro për sigurinë ndaj pesticideve - Nga viti 2026 nis projekti i ri për fuqizimin e laboratorëve në ISUV

Vitin e ardhshëm do të nisë një projekt i rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve laboratorike dhe ngritjen e infrastrukturës teknike për analizat e mbetjeve të pesticideve dhe metaleve të rënda në bimë. Projekti, i cili do të financohet në buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, ka një vlerë totale prej rreth 2.4 milionë eurosh.

Ky investim vlerësohet si i domosdoshëm, pas problematikave të shumta që kanë hasur prodhuesit shqiptarë, ku një sërë ngarkesash janë kthyer në doganë për shkak të nivelit të lartë të pesticideve, duke shkaktuar humbje të mëdha ekonomike.

Në këtë drejtim, investimi synon modernizimin e laboratorëve ekzistues, rritjen e pajisjeve analitike të stan-

dardeve të BE-së dhe zgjerimin e kapaciteteve teknike për monitorimin e sigurisë ushqimore dhe mjedisore. Me këtë projekt pritet të rritet saktësia, shpejtësia dhe transparenca e analizave të produkteve bimë, duke përmirësuar kontrollin e zinxhirit ushqimor dhe harmonizimin me praktikën ndërkombëtare.

Ky investim është thelbësor për rritjen e besueshmërisë së produkteve vendase në tregun e brendshëm dhe atë të eksportit, veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe agroindustrisë. Për më tepër, investimi pritet të kontribuojë në mbrojtjen e konsumatorit dhe minimizimin e rreziqeve shëndetësore që lidhen me nivelin e substancave të dëmshme në produktet bimë.

Punimet për ngritjen dhe pajisjen e laboratorëve të rinj pritet të nisin në fillim të vitit 2026, ndërsa projekti do të zbatohet në faza, dhe pritet të përfundojë në viti në 2028-ën.

Nga ana tjetër, paralelisht do të nisë një projekt për pajisje laboratorit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarë, (ISUV) në vlerë 4.3 milionë euro i cili gjithashtu përfundon në 2028.

Ky investim do të jetë një hap i rëndësishëm drejt rritjes së standardeve të sigurisë ushqimore dhe forcimit të konkurrueshmërisë së prodhimeve vendase në tregjet ndërkombëtare, në një kohë kur janë hapur edhe grupkapitujt e sektorit bujqësor për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Rreth 59 mijë fermerë të mbështetur nga Skema Kombëtare e Bujqësisë

Mbi 58,600 fermerë në gjithë vendin janë mbështetur deri më sot në kuadër të Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2025, me një vlerë to-

tale prej 2,23 miliardë lekësh, ndërkohë që pagesat vazhdojnë për përfituesit e tjerë.

Skema ofron mbështetje për tufën bazë të matrikul-

luar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fara, fidanë dhe inpute të tjera, bimët mjekësore dhe aromatike, ferment organike, certifikimin Global Gap, si dhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) nënvizon se programi synon të forcojë mbështetjen për fermerët dhe të avancojë zhvillimin rural në të gjithë vendin.

Skemat e mbështetjes përbëjnë mundësi reale për të modernizuar bujqësinë shqiptare, për të rritur prodhimin vendas dhe për të nxitur vetëpunësimin në zonat rurale.

Këtë vit Skemës Kombëtare të Investimeve 2025 me vlerë 20 milionë euro, i janë shtuar edhe dy instrumente financimi për investime që janë kredia e buta dhe garancia sovraane.



Salla: Vijon intensivisht puna për riparimin e argjinaturës së Vainit

Nën koordinimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ekipet e Drejtorisë së Ujitje-Kullimit në Lezhë, së bashku me emergjencat civile, Forcat e Armatosura dhe pushtetin vendor, vijnë prej orësh

punën në terren për të ndërhyrë në argjinaturën e Vainit, e cila u dëmtua sërish gjatë ditës së sotme.

Ministri i Brendshëm, Andis Salla ndau pamje mbrëmjen e të hënës nga puna që po zhvillohet

për forcimin e argjinaturës.

“Në Tale të Lezhës, ekipet e Drejtorisë së Ujitje-Kullimit, në bashkëpunim me emergjencat civile, Forcat e Armatosura dhe pushtetin vendor, vijon intensivisht punën për rehabilitimin e argjinaturës së dëmtuar, me qëllim minimizimin e dëmeve në tokat bujqësore dhe mbrojtjen e zonës”, shkruan Salla.

Reagimi i menjëhershëm dhe puna e koordinuar synojnë stabilizimin e situatës dhe garantimin e sigurisë së zonës, me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore.



Shirat pengojnë mbjelljet në Përmet - Sipërfaqet e kultivuara përgjysmohen

Reshjet e dendura të shiut kanë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në mbjelljet sezonale në zonën e Përmetit. Sipas agronomit Robert Stefanidhi, sipërfaqet e mbjella këtë vit janë përgjysmuar krahasuar me vitin e kaluar.

“Për momentin situata është më e vështirë se vitet e tjera sepse ka pasur reshje të shumta të cilat kanë ndikuar negativisht si për punimin, kullimin e arave etj. Mbjellja e grurit është pak më poshtë se vitet e tjera sepse lagështira ka bërë punën e saj”, u shpreh Stefanidhi.

Stefanidhi u bën thirrje fermerëve që planifikojnë të kultivojnë kulturat sezonale të tregojnë kujdes të shtuar në tra-



jtimin e tokës.

“Ndikon punimi i mirë, hedhja e plehut të duhur, superfosfatit i cili është bazë për të mbjellat”, tha ai.

Në zonën e Përmetit ka një numër të konsiderueshëm

fermerësh që kultivojnë kryesisht grurë, tërshërë, elb dhe kultura të tjera bazë, të cilat këtë vit rrezikojnë të kenë prodhim më të ulët për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike.

MINISTRIA E BUJQËSISË, UNIDO DHE SECO FORCOJNË THEMELET E QASJES LEADER DHE PËRGATISIN TERRITORET PËR FONDET E BE-SË NË SHQIPËRI

PROCESI I REGJISTRIMIT TË GVV-EVE DHE SHKËMBIMET ME HOMOLOGËT ITALIANË PO KRIJOJNË NJË MODEL TË RI ZHVILLIMI RURAL TË ORIENTUAR NGA KOMUNITETI, DUKE KONSOLIDUAR BAZAT PËR QEVERISJE TË QËNDRUESHME, KOORDINIM INSTITUCIONAL DHE AKSES EFEKTIV NË FONDET E BASHKIMIT EVROPIAN

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Në kuadër të angazhimit të përbashkët për të ndërtuar struktura të qëndrueshme të qeverisjes vendore dhe për të promovuar zhvillimin rural të bazuar në evidencë, Programi Global i Cilësisë dhe Standardeve (GQSP Albania), i zbatuar nga UNIDO dhe i financuar nga SECO, po mbështet Shqipërinë në konsolidimin e katër Grupeve Vendore të Veprimit (GVVs) dhe në përafrimin e tyre me kërkesat e modelit evropian LEADER. Këto veprime synojnë të garantojnë që strukturat vendore të ngrihen mbi parimin e planifikimit të orientuar nga të dhënat, pjesëmarrjes komunitare dhe qeverisjes së mirë, duke krijuar themele të forta për akses në fondet e zhvillimit rural të Bashkimit Evropian.

Në Puglia: aty ku bashkohen tradita dhe inovacioni



Në kuadër të këtyre përpjekjeve, GQSP Albania organizoni një vizitë studimore përfaqësuesve të katër GVV-eve të Shqipërisë në rajonin e Pulias, Itali. Delegacioni shqiptar pati mundësinë të punojë nga afër me dy prej GVV-eve më të konsoliduara italiane, GAL Alto Salento 2020 dhe GAL Valle d'Itria. Përmes diskutimeve të detajuara mbi qeverisjen e strukturave vendore, hartimin e strategjive territoriale dhe menaxhimin e fondeve të BE-së, pjesëmarrësit u njohën me modele konkrete të funksionimit të qasjes LEADER në praktikë. Programi u pasurua me vizita në disa sipërmarrje rurale të mbështetura ndër vite nga këto GVV-e, përfshirë Tedesco Fattorie Grottamiranda, Agriturismo Masseria Cappella, I Giardini di Pomona dhe Masseria Carrone. Këto shembuj ilustruan se si investimet e orientuara nga komuniteti mund të nxisin zhvillim ekonomik, të ruajnë identitetin territorial dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e sektorit rural.



Në fermën Tedesco Grottamiranda, dy vëllezër të rinj, Angelo dhe Carmelo, rrëfyerin sesi një ide e thjeshtë u shndërrua në projekt zhvillimi falë mbështetjes LEADER: “Na duhej dikush të besonte tek ne para se të kishim rezultatet. GAL-i e bëri pikërisht këtë.” Shqiptarët dëgjonin me



vëmendje, sepse kjo histori u ngjan shumë komuniteteve të tyre – të pasura me ide, por shpesh pa mekanizma për t'i kthyer ato në realitet.



Në Masseria Cappella, në Giardini di Pomona dhe në Masseria Carrone, tradita u ndërthur me modernitetin. Produktet “kilometër zero”, bujqësia organike, turizmi rural dhe ruajtja e trashëgimisë u bënë pjesë e një rrëfimi të përbashkët: territorët mund të lulëzojnë, nëse njerëzit bashkëpunojnë dhe nëse vendimet merren pranë tokës, jo larg saj.

Workshop-in Ciheam Bari



Vizita u përmbyll me një sesion të dedikuar të zhvilluar në CIHEAM Bari, ku ekspertë ndërkombëtarë prezantuan qasje bashkëkohore mbi transformimin e sistemeve agroushqimore, qeverisjen shumë-nivelëshe dhe mundësitë e financimit të projekteve të reja. Sesioni theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik, privat, akademisë dhe shoqërisë civile, një komponent kyç i modelit LEADER, dhe nënvizoi se si qasja e udhëhequr nga komuniteti mund të prodhojë politika më gjithëpërfshirëse dhe rezultate të qëndrueshme.


Në CIHEAM Bari, ekspertët ndërkombëtarë i dhanë vizitës dimensionin akademik dhe strategjik. U diskutua transformimi i sistemeve ushqimore, roli i komuniteteve blu e të



gjelbra dhe mundësitë për projektet e reja të BE-së. Disa nga pjesëmarrësit e përshkruan workshop-in si “momentin kur mozaiku filloi të marrë formë”.

Ministria e Bujqësisë Konsolidon Strukturat e Reja të LEADER-it, së bashku me UNIDO dhe SECO

Gjithashtu, përfaqësuesit e katër GVV-eve u takuan me Drejtorinë e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Zhvillimit Rural për të koordinuar fazën finale të regjistrimit të tyre. Takimi u fokusua në konsolidimin e procedurave ligjore, përgatitjen e dokumentacionit për autorizimin ministror dhe harmonizimin e modeleve të tyre të funksionimit me kuadrin kombëtar të qasjes LEADER. Diskutimet synuan të siguronin që strukturat e reja të jenë të afta të operojnë në mënyrë të rregullt dhe të marrin pjesë në thirrjet e ardhshme të financuara nga Bashkimi Evropian.



Ky kombinim i shkëmbimit ndërkombëtar me konsolidimin institucional brenda vendit përfaqëson një qasje të integruar të UNIDO, SECO dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për modernizimin e qeverisjes vendore në Shqipëri. Ashtu si UNIDO nxit përdorimin e mjeteve analitike dhe indikatorëve të bazuar në evidencë për sektorët industrialë dhe infrastrukturën e cilësisë, mbështetja për qasjen LEADER reflekton po këtë filozofi: fuqizimin e vendimarrjes së mbështetur në të dhëna, rritjen e kapaciteteve vendore dhe adoptimin e praktikave ndërkombëtare në planifikimin e zhvillimit rural.

Përmes këtyre ndërhyrjeve, Shqipëria po ndërton një bazë më të fortë për qeverisjen vendore, po krijon ura bashkëpunimi me modele të suksesshme evropiane dhe po përgatitet të përfitojë në mënyrë më efektive nga instrumentet e financimit të BE-së. Ky proces shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm territorial dhe integritetit evropian, duke reflektuar qasjet moderne të mbështetura ndër vite nga UNIDO në vendet partnere në mbarë botën.

BUJQËSIA

Pesticidet pengojnë eksportin, kultivuesit e ullirit ankohen për situatën e krijuar vitet e fundit

Kjo fabrikë e prodhimit të vajit të ullirit në Papër të Elbasanit ka një kërkesë për

vitet e fundit është një plagë që është hapur në Shqipëri. Më parë ishte më lehtë të gjeje vaj

tohet fermeri, bllokohen fabrikat. Fermeri mbeten me një produkt që nuk shitet”, shprehet prodhuesi Ritch Doçi.

Prodhuesit gjykojnë se dëmi i parë nga prania e pesticideve tek ulliri ka rënë mbi ta, por shumë shpejt nga ky dëm nuk do të shpëtojë as fermeri.

“Kontrolli i pesticideve bëhet duke krijuar komunitete me ekspertë të fushës dhe duke kështilluar në mënyrë të hapur fermerët. Prodhuesit po e po, por prodhuesi e di se e ka pësuar tek xhepat e tij, fermerët ende jo, është valë që po i vjen”, thotë prodhuesi.

Qarku i Elbasanit është një nga prodhuesit kryesorë të vajit të ullirit në vend. Teksa çmimi po shkon drejt një standardizimit, probleme të tjera duket se po rëndojnë mbi fermerët apo prodhuesit.



eksport të vajit drejt SHBA, kërkesë të cilën nuk arrin ta plotësojë totalisht tashmë prej një tjetër problemi.

“Pesticidi prezent në 10

ulliri Bio, pa certifikatë, por bio, ndërsa tani mbetjet janë të larta. Kjo dëmton fabrikën dhe prodhuesin, por si çdo gjë në biznes është zinxhir, nesër dëm-

Administrimi i pyjeve e kullotave - Çmime referencë për hartimin e projekteve dhe planifikimin e investimeve publike

Ministria e Mjedisit ka nxjerrë për konsultim publik një projektvendim që synon të unifikojë mënyrën se si kryhen punimet në fondin pyjor dhe kullor në gjithë vendin. Drafti parashikon miratimin e normave, standardeve teknike, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira për të gjitha operacionet që lidhen me administrimin, rigjenerimin dhe shfrytëzimin e pyjeve dhe kullotave.

Sipas dokumentit, për herë të parë pas gati 40 vitesh, normat e punës dhe standardet e shfrytëzimit do të përditësohen për t’iu përshtatur realitetit të tregut, zhvillimeve teknike dhe praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm. Çmimet bazë të llogaritura do të shërbejnë si referencë për hartimin e projekteve, për llogaritjet financiare të bashkive dhe për planifikimin e investimeve publike në këtë sektor.

Punimet në pyje dhe kullota do të ndahen në katër kategori, sipas vështirësisë së operacionit, duke u bazuar në pagën

zioni, si dhe inventarizimin e territorit pyjor dhe kullor.

Sipas relacionit shpjegues, akti synon të forcojë admin-



minimale dhe koeficientët përkatës të indeksimit. Drafti përcakton standarde të reja për pyllëzimet, prerjet kulturore, sistemimet malore, mbarëshkrimin e pyjeve, ndërtimin e pritave për mbrojtjen nga ero-

istimin e fondit pyjor, të rrisë efikasitetin e punës dhe të mbrojë biodiversitetin, duke siguruar që veprimtaritë të kryhen në mënyrë të unifikuar nga institucionet publike dhe subjektet private.

Është mbledhur këtë të martë Komisioni i Ekonomisë, ku po mbahet një seancë dëgjimore me grupet e Interesit për paketën Fiskale.

Gentjan Lalaj, nga shoqata e blegtorëve, prodhues të qumështit, u ndal në disa problematika që has ky sektor, duke kërkuar ndër të tjera që vendoset një barazim TVSH, dhe që blegtorët vendas të kenë mundësinë që të shesin prodhimet e tyre.

“Është një paradoks, u kërkua qumësht nga Italia në vendin tonë, dhe ne nuk e shisnim dot se nuk na lejohej të krijojmë një kooperativë. Atëherë dhe ne po e çojmë

S’blejmë dot nga prodhuesit tanë, importojmë nga serbi”, shoqata e blegtorëve ngre shqetësimet në Komision, Braçe u del në krah, kritika ministrisë

qumështin jashtë. Ka ferma që nuk u merret qumështi për arsyet që i dimë shumë mirë.

Kërkojmë barazim TVSH sado të vendoset. Fermerët shqiptarë nuk na i shesin dot produktet sepse dhe ne nuk i blejmë dot sepse ne nuk na njihet TVSH në sistem, dhe detyrohemi dhe blejmë misër dhe elb serb, produkte që vijnë nga rajoni dhe nuk ua bëjmë

dot komshinjeve tanë që luten që t’ua blejmë me një çmim mizerabel”, tha ai.

Sa i përket “kooperativës”, ai tha se kjo nuk është e mundur që të realizohet.

“Bashkimin e fermerëve e shikojmë si diçka të përcaktuar, sot nuk po bëhet vëllai me vëllanë, dhe jo 7 blegtorë. Ne e kemi thënë dhe në ministrinë e bujqësisë.... është

Cilat janë 28 zonat e reja prioritare të zhvillimit? - Përcaktohen fshatrat ku i hapet rrugë investimeve në Shkodër, Mat dhe Shijak

Qeveria ka miratuar 28 zona të reja me përparësi zhvillimi në bashkitë Shkodër, Mat dhe Shijak. Çdo individ që ka në përdorim një tokë prej më shumë se 10 vitesh, ka një plan biznesi dhe kërkon të investojë në këto zona, mund të përfitojë blerjen e tokës me një vlerë simbolike prej 1 euro.

Konkretisht, referuar vendimit të qeverisë, 3 zonat e përcaktuara në Bashkinë Mat, janë zona e liqeneve të Gërmanit, fshati Selixë, zona ish-Vila e Zogut, fshati Selixë, zona e kurorës së fshatit Selixë; pjesë e njësive administrative Koms, më një total prej 620 ha tokë.

Në bashkinë Shijak, janë përcaktuar 20 zona me përparësi zhvillimi, siç janë njësia administrative Maminas, zona Rubjek; rezervuari Rubjek 1 dhe 2; njësia administrative Maminas, zona Karrec; rezervuari i Karrecit, njësia administrative Maminas, zona Metallë; rezervuari i Metallës dhe Karpenit; njësia administrative Gjepalaj, zonat Shetël dhe Likesh; rezervuari i Callikës;

njësia administrative Gjepalaj, zona Çizmeli, njësia administrative Gjepalaj, zona Kënetë,

fshati Sheld; njësia administrative Guri i Zi, fshatrat Mazrek – Shpor. Në total, në këtë



rezervuari i Shtrazës, njësia administrative Gjepalaj, zona Gjepalaj, rezervuari i Terzies. Në total 302 hektarë në dispozicion për t’u investuar.

Në bashkinë Shkodër, është përcaktuar njësia administrative Shalë, fshati Theth; njësia administrative Shalë; fshati Nderlyasaj, njësia administrative Guri i Zi, fshati Rragam; njësia administrative Guri i Zi,

bashki janë 4420 hektar, që janë të gatshme për investim në këtë bashki.

Llojet e aktiviteteve, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë ato të zhvillimit ekonomik; industriale dhe turistike.

Ndërkohë në fillim të muajit qeveria shpalli zonat e para me përparësi zhvillimi në Elbasan, Belsh, Përmet dhe Skrapar, në kuadër të “Paketës së Maleve”.

32 vite përkushtim në blegtori - Asim Banushaj vazhdon traditën familjare

Në fshatin Nepravishtë, prej më shumë se tri dekadash, Asim Banushi ka ndërtuar një histori suksesi në bujqësi dhe blegtori. Që nga viti 1993, ai i është përkushtuar rritjes së gjedhit, deleve, derrave dhe krerëve të tjerë blegtoral, duke zhvilluar një fermë që sot renditet ndër më të konsoliduarat në zonë.

“Më parë kam mbarështuar rreth 15-20 krerë lopë, dhe tani kam krerë të tjerë”, u shpreh Banushaj.

Ai thotë se gjithmonë ka qenë i përqendruar tek prodhimi bio. Mungesa e fuqisë punëtore mbetet problemi kryesor me të cilin Asimi dhe dhjetëra fermerë të tjerë në zonë përbal-

len çdo ditë.

“Kemi mungesë të fuq-

Megjithatë,

Banushi mbetet i vendosur



isë punëtore, jam i detyruar të angazhoj familjarët e mi sepse sado ti paguash nuk vjen njeri”, tha ai.

të vazhdojë punën në tokën dhe fermën e tij, duke e konsideruar bujqësinë një mënyrë jetese.

që digjet, përmytet e kështu me radhë. Të gjitha propozimet që bëri dhe i ka bërë kohë pas kohe, nuk kanë kosto për buxhetin e shtetit, janë rregulime në atë që kemi sot pa shtuar asnjë lek kosto.

Kjo historia që ministria thotë që do e bëjmë kështu siç themi ne, ka sjellë këtë gjendje. Ka dy muaj në detyrë ministri i bujqësisë, mund të reflektonte, por tha që ‘jam i kënaqur’. Mistri i financave i ka dëgjuar këto problematika. Përfaqësuesi i dhomës së tregtisë, siç koordinojnë çmimin koordinojnë dhe sjelljen, dhe e kuptoj pse nuk kanë ardhur sot këtu”, tha Braçe.

AKTUALITET

Shpallen 20 zona për investime industriale dhe turistike në Shijak

Këshilli i Ministrave ka vendosur shpalljen e disa zonave në bashkinë Shijak si “zona me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore”, një masë e rëndësishme që synon të nxjerrë në pah potencialin ekonomik dhe turistik të territoreve malore të kësaj bashkie.

Sipas vendimit, zonat zhvillimore përfshijnë njësitë administrative Maminas dhe Gjepalaj dhe shtrihen rreth rezervuarëve kryesorë të zonës, përkatësisht Rubjek 1 dhe 2, Karrec, Karpen, Metallë, Callikës, Çizmelisë, Shtrazës dhe Terzies. Sipërfaqet e këtyre zonave variojnë nga 1,4 hektarë deri në 169,56 hektarë, sipas hartave të sistemit KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto dhe të bashkëlidhura vendimit.

Konkretisht, zona më e madhe zhvillimore është Rubjek 2 në njësinë administrative Maminas, me 169,56 ha, ndërsa zona më e vogël është rezer-

vuari i Metallës, me 1,4 ha.

Të gjitha këto zona janë të përcaktuara me kujdes për të

turistik.

Shtirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes dhe daljes së këtyre



mundësuar zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, duke përfshirë investime në sektorin industrial dhe atë

zonave përcaktohen në hartën treguese, duke mundësuar monitorim dhe menaxhim efektiv të zhvillimeve në terren.

Pas 30 vitesh largimi dhe punë në Evropë, Kitmir Jeminaj rikthehet në Kukës për të vazhduar zanatin e furrtarit

Pas 30 vitesh largimi dhe pune në Evropë, Kitmir Jeminaj është rikthyer në Kukës, për të

gjithmonë afër. Jeminaj tregon se rruga nuk ka qenë aspak e lehtë, por thekson se puna e ndershme

ta provuar”, u shpreh Kitmiri.

Ai rrëfen se zanati i furrtarit është ndër më të lodhshmit, pasi dita nis që në orën dy të mëngjesit. Nga përgatitja e brumit deri te pjekja e bukës, gjithçka kërkon vëmendje dhe përkushtim të plotë.

Tradita e furrtarisë tashmë po vazhdohet edhe nga dy djemtë e tij, dhe ta trashëgojnë këtë zanat. Por, sipas Jeminajt, hapja e një aktiviteti të tillë në Kukës shoqërohet me shumë vështirësi, që nga kostot e larta deri te mungesa e fuqisë punëtore.

“Çmimet nuk janë të mira, duhet të mundohesh për të nxjerrë një ditë pune”, tha ai.

Mesazhi i tij për të rinjtë është të shikojnë mundësinë për të punuar dhe për të jetuar në vendlindje.



vazhduar zanatin e furrtarit që e ka shoqëruar gjithë jetën. Ai ka vendosur të ndërtojë jetën dhe aktivitetin e tij në vendlindje, duke u rikthyer te zanati që e ka pasur

gjithmonë jep rezultat.

“Me këtë profesion kam 30 vite që merrem, në Austri, Hungari, Francë, Gjermani dhe tashmë jam kthyer në shtëpi për

Demo: 40 bashki përzgjedhin zonat prioritare për Paketën e Maleve, në 2026 nisin investimet e para

Ministri për Pushtetin Vendor, Ervin Demo, tha se gjatë 3- muajit të parë të vitit 2026 do të kemi investimet e para në kuadër të “Paketës së maleve”.

Në një intervistë për mediet ai informoi se kjo paketë do të zhvillohen në 8 bashkitë të cilave tashmë u janë miratuar zonat prioritare.

“Tremujori i parë i 2026, do të jetë tremujori i cili do shohim le të themi dallëndyshe e para të rasteve të cilat do të jenë të gatshme vazhdojnë më pas me procedurat e marrjes së lejes së ndërtimit, për të vazhduar me procesin e marrjes së dokumentacionit të pronësisë. Ne kemi bashkinë Përmet, Skrapar, Elbasan,

Belsh, Kukës, Shkodër, Shijak, Mat, që tashmë kanë të miratuar zonat prioritare. Përfundojmë me Vaun e Dejës, me Bashkinë Klos, Bashkinë Memaliaj, dhe javët që vijnë më pas do të kemi Bashkinë Vlorë”, tha Demo.

Demo bëri të ditur se, “janë rreth 40 bashki deri tani që kanë filluar procesin e përzgjedhjes së zonave prioritare”.

Sipas tij, objektivi është që deri në muajin janar të kemi përmbyllur përcaktimin e zonave prioritare siç e përcak-



Shqipëria, pjesëmarrëse në asamblenë e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit në Spanjë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përfaqësoi Shqipërinë në punimet e Asamblesë së 122-të të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit (COI), e cila u zhvillua në Kordoba (Spanjë).

Delegacioni shqiptar, i përbërë nga Bledi Mile dhe Ana Lelo, u prit nga ministri i Bu-

jqësisë së Spanjës si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i COI.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla i përcolli një videomesazh përshëndetës asamblesë, ku theksoi traditën mijëra vjeçare të kultivimit të ullirit në Shqipëri dhe rëndësinë e tij në identitetin mesdhetar, zhvillimin rural dhe

ekonominë bujqësore të vendit.

Gjatë punimeve, Shqipëria riafirmoi angazhimin për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të ullirit, forcimin e cilësisë së prodhimit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe promovimin e produkteve Made in Albania në tregjet ndërkombëtare.



Rikthehet tregu i imëtave në Shkodër - U ndaluan pas zbulimit të murtajës së ruminantëve të vegjël

Fermerët në tregun e Stom Golemit i janë rikthyer nor-

rim i të ardhurave për ta. Ata thonë se në zonat e tyre nuk

“Kemi qenë të bllokuar për tregun por ligji duhet zbatuar”, u shpreh një tregtar.

“Ne si zonë nuk kemi pasur probleme kurrë sepse i kemi pasur bagëtinë të shëndetshme”, tha një tjetër tregtar.

Prej muajit korrik në qarkun Shkodër u ndalua tregtimi i imtave pas zbulimit të 3 rasteve me murtajë tek ruminantët e vegjël ku u asgjësuan rreth 700 krerë.

Tashmë tregu është rikthyer në çdo zonë duke u dhënë mundësi fermerëve por edhe konsumatorëve që të marrin produkt të sigurt. Pritet që shitjet të jenë të larta veçanërisht gjatë muajit dhjetor ku edhe konsumi i mishit është më i madh.



malitetit pas thujasë 5 muajsh duke tregtuar të imtat.

Tregtarët shprehën të kënaqur pasi shitjet janë bu-

ka pasur asnjë rast me murtajë, megjithatë janë detyruar të zbatojnë masat kufizuese, ndonëse me kosto ekonomike.

“Paketa e maleve zgjidh një nga problemet që mund të jetë lidhur me pronësinë. Por së dyti patjetër është përjashtimi nga detyrimet, duke filluar që nga taksat e ndërtimit, por më pas edhe përjashtimin nga TVSH-ja. 500 raset e para që do fillojnë të investojnë përmes Paketës së Maleve, do të jenë përfituesi të këtyre iniciativave që janë shumë të rëndësishme për këtë biznes”, theksoi ministri.

Paketa e Maleve është një nismë ligjore dhe zhvillimore e Qeverisë Shqiptare që synon të nxisë investimet dhe rigjallërojë jetën ekonomike në zonat malore të vendit.

ton dhe vetë ligji.

Ai tha se, “të gjithë personat që do të aplikojnë do të shprehin interesin, i cili do të jetë më pas edhe i mbështetur me dokumentacionin përkatës siç e parashikon ligji. Janë bashkitë ato që do marrin këto aplikime, do bëjnë verifikime në terren dhe do ndjekin hapat ligjorë për të garantuar transparencë për komunitetin”.

Gjithashtu vuri në dukje Demo, aplikuesit e parë do të përfitojnë edhe lehtësira fiskale.

INFORMACIONE

“Të ngrihen komunitetet e energjive të rinovueshme” - Mazreku: Avantazhe për çmimin dhe varfërinë energjetike, të lehtësohen procedurat

“Shfrytëzimi i mëtejshëm i potencialit që kanë burimet e rinovueshme të energjisë për Shqipërinë është domosdoshmëri, ndërkohë që përshtetimi i procesit të krijimit të komuniteteve të energjive të rinovueshme është një prej tyre”. Gjatë Tryezës së Rrumbullakët Politike mbi Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri, organizuar nga organizata Milieukontakt, u vu theksi te avantazhet që ka krijimi i këtyre grupeve.

“Çmimi është një element shumë i rëndësishëm dhe në momentin që energjiat vetëprodhohet, patjetër që çmimi është një element tjetër in tregut dhe i mënyrës sesi zhvillohet, por njëkohësisht ana sociale dhe elementini i varfërisë energjetike është një lloj zgjidhje sepse këto lloj komunitetesh lokale, grupe njerëzish në njëfarë mënyre adresojnë edhe problemet që kanë të bëjnë me

varfërinë energjetike. Shumë i rëndësishëm është edhe elementi i kursimit, i fitimit që do të krijohet dhe mënyra e shpërndarjes së tij me komunitetin, duke mbështetur nevojat lokale dhe ky është komponenti i fortë social. Pra, në njëfarë mënyre është një grup që synon për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe të gjithë përfitojnë së bashku”, - u shpreh Valbona Mazreku, drejtore ekzekutive e Milieukontakt.

Aktualisht, këto bashkime energjetike qytetarësh nuk ekzistojnë në vendin tonë.

“Komunitete të energjive të rinovueshme nuk është se ka në Shqipëri, aq më tepër të regjistruara. Ka tentatva, por akoma jo të regjistruara. Ndërkohë që, ajo që kemi vënë re, ne jemi duke e përafruar gjithë legjislacionin me Direktivat e Bashkimit Evropian, që kanë të bëjnë me pjesën e energjive të rinovueshme, por aktet nën-

ligjore mbeten ende të paplota duke e bërë të vështirë këtë gjë. Procedurat po ashtu janë të paqarta dhe të ngadalta, të vështira për t'u ndjekur duke kufizuar këstu pjesëmarrjen e konsumatorëve komunitarë, pra njerëzit, bashkimi i komuniteteve. Duket se ka edhe pengesa të tjera strukturore të cilat e vështirësojnë këtë lloj zbatimi efektiv”, - tha Mazreku.

Një komunitet energjie është një grup njerëzish që bashkohen për të planifikuar, investuar dhe menaxhuar projekte për energjinë e pastër, që nga pjesa e planifikimit teknik, në mënyrën sesi do të bëhet modeli i biznesit, instalimi i teknologjive, por njëkohësisht edhe mirëmbajtja e tyre. Ai u lejon anëtarëve që të marrin në dorë kontrollin e prodhimit dhe të konsumit, duke ofruar edhe një nivel decentralizimi të sistemit të energjisë.



Dëme të mëdha pas përmbytjes në Zhelizhan - Fermerët e Lushnjës kërkojnë vlerësim të humbjeve pas tërheqjes së ujit

Pas përmbytjeve të ditëve të fundit, në Zhelizhan të Lushnjës janë konstatuar dëme të konsiderueshme, sidomos në serat dhe tokat e vëllezërve Naun dhe Trifon Shtëmbari, të cilëve lumi Seman u shkatëroi të mbjellat pas daljes nga shtrati.

“Serrat dhe agrumet nuk bëhen fare, kjo është zonë e mbytur”, u shpreh Naun Shtëmbari.

Bashkia e Lushnjës ka qenë në gatishmëri gjatë reshjeve, ndërsa drejtori i Emergjencave Civile, Avni Begolli, thotë se po kryhen verifikimet dhe në fund do të vendoset për dëmshpërblimet. Ai thekson se përmbytjet kanë prekur vetëm zonat brenda argjinaturave.

“Në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pasurisë Publike

dhe jo vetëm kemi ndërhyrë në kohë reale për të normalizuar



situatën. Kemi pasur probleme në disa biznese dhe familje në fshatin Savër dhe është bërë ndërhyrja e menjëhershme për normalizim të situatës”, u

shpreh Avni Begolli, drejtor i EC, Bashkia Lushnje.

Fermerët kërkojnë vlerësim të menjëhershëm të humbjeve, për një mundësi kompensimi, pasi dëmet janë të parikuperueshme.

Financimi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike - 4 burime për gjetjen e 9.1 mld USD, nga buxheti te PPP-të dhe obligacioni i gjelbër

Teksa Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026–2036 kërkon 9.8 mld USD ndërhyrje, ndërsa hendeu financiar arrin në 9.1 mld USD, në draftin e nxjerrë për konsultim publik parashikohen një sërë formash për gjetjen

e tyre buxhetore afatmesme mbështesin objektivat e adaptimit. Për herë të parë, vendi pritet të zbatojë Etiketimin e Buxhetit për Klimën, një sistem që gjurmon shpenzimet publike të lidhura me përshtatjen dhe e kthen buxhetimin e gjelbër



e financimit, duke kombinuar burimet vendase me fondet ndërkombëtare dhe kapitalin privat. Sipas dokumentit, deri në vitin 2030 të paktën 20% e fondeve të nevojshme duhet të mobilizohen nga buxheti i shtetit, ndërsa ministritë do të duhet të tregojnë se si programet

në një proces standard të politikëbërjes.

Në të njëjtën kohë, Shqipëria synon të zgjerojë aksesin në financimin ndërkombëtar për klimën, përmes partneriteteve me Fondin për Klimën e Gjelbër, Fondin Global të Mjedisit, Fondin e Përshtatjes dhe programet

IPA të Bashkimit Evropian.

Ndërkohë, një pjesë e rëndësishme e financimit pritet të vijë edhe nga sektori privat. Qeveria planifikon të nxisë përdorimin e Partneriteteve Publike-Private, si dhe të zhvillojë instrumente sigurimesh për risqet klimatike, përfshirë bujqësinë dhe sektorët e cenueshëm.

Në fushën e inovacionit financiar, Shqipëria po punon për studimin e fizibilitetit të obligacionit të parë të gjelbër kombëtar, parashikuar për vitin 2026, si dhe për krijimin e një strukture rajonale sigurimi kundër rreziqeve klimatike. Këto instrumente synojnë të diversifikojnë burimet e financimit dhe të rrisin qëndrueshmërinë fiskale të vendit ndaj ngjarjeve ekstreme të motit.

Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026–2036 është një dokument strategjik që synon rritjen e aftësisë së vendit për t'u përballur me rreziqet klimatike dhe pasojat e tyre ekonomike e sociale.

Siguria e ullishtave, ekspertët shqiptarë në takimin rajonal në Itali

Ekspertë nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) morën pjesë në takimin rajonal të dedi-

Fokusi kryesor i aktivitetit ishte sëmundja bakteriale “Xylella Fastidiosa”, e cila përbën kërcënim serioz për ullishtat dhe një sërë bimësh të tjera në vendet e Mesdheut. Takimi

Kosovën, Bosnje Hercegovinën, Serbinë dhe Shqipërinë. Delegacioni shqiptar, i përbërë nga ekspertë të AKU dhe AKVMB, kontribuoi me eksperiencën e tyre teknike dhe prezantoi qasjet që po aplikohen në vend për monitorimin dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve bakteriale.

Gjatë takimit u trajtuan tema të rëndësishme, si: metodat moderne të parandalimit dhe kontrollit të “Xylella Fastidiosa”, legjislacioni dhe rregulloret e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e bimëve; gjendja aktuale e dëmtuesit, përfshirë bartësit, simptomat, shpërndarjen dhe epidemiologjinë; zhvillimet e fundit shkencore dhe teknologjike në fushën e fitopatologjisë; aplikimi i praktikave të reja në terren dhe rezultatet e arritura nga vendet pjesëmarrëse; fushatat e ndërgjegjësimit dhe komunikimit për fermerët dhe komunitetet bujqësore.

Pjesëmarrja e ekspertëve shqiptarë në këtë takim shënon një hap të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e përputhshmërisë së standardeve me ato të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së bimëve.

Ky bashkëpunim rajonal pritet të sjellë përfitime të drejtpërdrejta edhe në menaxhimin e rreziqeve fitosanitare në Shqipëri, duke ndihmuar në ruajtjen e prodhimit vendas dhe garantimin e cilësisë së tij.



kuar standardeve të sigurisë ushqimore dhe menaxhimit të sëmundjeve që rrezikojnë bujqësinë mesdhetare.

Takimi u zhvillua në rajonin e Pulias, Itali, në Qendrën Ndërkombëtare për Studime të Avancuara Agronomike Mesdhetare (CIHEAM).

synoi shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet vendeve pjesëmarrëse dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal për mbrojtjen e bimësisë dhe sigurisë ushqimore.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga disa vende të Ballkanit, përfshirë Malin e Zi,

INFORMACIONE

‘Paketa e Maleve’, kryebashkiaku i Hasit: Kemi miratuar zonat që do të përfitojnë, jemi në pritje të konfirmimit nga qeveria

Myftar Dauti bëri të ditur gjithashtu se Bashkia Has pret aprovimin e fondeve për 33 projekte investimesh të depozituara pranë ministrive, që synojnë zhvillimin e zonës

Bashkia Has është në pritje të miratimit nga qeveria të zonave përfituese në kuadër të programit “Paketa e Maleve”.

e interesuar për të investuar në Has.

Sipas tij, Këshilli Bashkiak ka miratuar zonat prioritare

zonat që do të përfitojnë nga Paketa e Maleve dhe jemi në pritje të miratimit nga qeveria”, tha Myftar Dauti, kryetar i Bashkisë Has.

Kryebashkiaku Dauti bëri të ditur gjithashtu se Bashkia Has pret aprovimin e fondeve për 33 projekte investimesh të depozituara pranë ministrive, që synojnë zhvillimin e zonës.

Gjatë takimit në Londër, emigrantët hasjanë shprehën interes për investime në vendlindjen e tyre, si në kuadër të “Paketës së Maleve”, ashtu edhe për projekte të përbashkëta me bashkinë, në fusha që lidhen me turizmin malor, bujqësinë dhe shërbimet.

Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit midis institucioneve lokale dhe diasporës, me synim kthimin e emigrantëve në kontribues aktivë për zhvillimin ekonomik të Hasit.



Kryetari i Bashkisë, Myftar Dauti, deklaroi pas një takimi me diasporën hasjane në Londër, të organizuar gjatë festave të nëntorit, se tashmë janë mbledhur kërkesat dhe prioritetet si nga banorët e zonës, ashtu edhe nga emigrantët

dhe dokumentacioni përkatës është dorëzuar pranë institucioneve përkatëse, ndërsa pritet tani vendimi përfundimtar i qeverisë.

“Tashmë kemi të hartuara prioritetet dhe kërkesat. Këshilli Bashkiak ka miratuar

Jaupaj: Diferencimi në burim, sfida tjetër për menaxhimin e mbetjeve

Në Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve në Tiranë puna vijon pa asnjë ndalesë, ku kryhen të gjitha hallkat e menaxhimit modern të mbetjeve.

Falë investimeve tashmë po rikualifikohet edhe i gjithë peizazhi përreth, ndërsa synimi mbetet rritja e sasisë së mbetjeve të rikuperuara dhe të ricikluara, për të ulur volumin që përfundon në landfill.

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj, inspektoi punën në terren, ku theksoi se diferencimi në burim do të jetë edhe sfida tjetër për menaxhimin e mbetjeve.

“Nuk mjaftojnë vetëm investimet që kryhen në pikat fundore të mbetjeve. Ministria e Mjedisit është e angazhuar përmes programeve të mëdha për të plotësuar të gjitha nevojat me infrastruktura fundore në të gjithë Republikën”, u shpreh ai.

Por diferencimi në burim, sipas Jaupajt, është një sfida që Ministria e Mjedisit do e ndjekë me njësitë e qeverisjes

vendore që janë përgjegjëse për ta prezantuar në qytete.

që ato mbetje që shërbejnë si ekonomi qarkulluese të mund



Ministri vlerësoi se programi i edukimit mjedisor me nxënës dhe studentë po sjell një energji të re në arritjen e këtij objekti.

“Iniciativa që keni marrë bashkë me orët mjedisore dhe edukimin me nxënësit krijon një premisë të mirë për ta prezantuar këtë në mënyrë të suksesshme. Qëllimi është që ne të kemi një diferencim më të madh të mbetjeve në mënyrë

të shiten për të rritur vlerën financiare”, tha Jaupaj.

Ministri theksoi se sasia e mbetjeve që do të depozitohet në landfill duhet të jetë sa më e vogël, minimale, që të rrisë jetëgjatësinë e landfillleve.

“Shqipëria nuk e ka luksin të ketë shumë landfille sepse është një vend shumë i vogël, megjithatë me procesin e diferencimit dhe kapsulimit po bëhet një punë shumë e mirë”, shtoi ai.

Dita e Gështenjës” mbledh dhjetëra vizitorë dhe prodhues vendorë

Në kompleksin “Fetnete Ramosaj” në Deçan u mbajt “Dita e Gështenjës”, e cila ka mbledhur dhjetëra vizitorë dhe prodhues vendorë. Përveç gështenjave, janë ekspozuar edhe produkte të tjera vendore si mjaltë, punime tradicionale, duke krijuar një atmosferë të

ngrohtë e mikpritëse.

Kryetari i Komunës së



Deçanit, Bashkim Ramosaj theksoi rëndësinë e këtij panairi për të promovuar prodhimet lokale dhe për të mbështetur ekonominë familjare. Ai përmendi pjesëmarrjen e artistëve nga trevat shqiptare dhe diaspora, duke e bërë këtë një event të veçantë kulturor.

Ndryshimet klimatike - Shqipëria mund të humbasë 7% të PBB-së, në 1 dekadë duhen 9.8 mld \$ investime! Bujqësia e turizmi, më të rrezikuarit

Shqipëria mund të humbasë deri në 7% të prodhimit Kombëtar nëse nuk merr masa për tu mbrojtur nga ndryshimet klimatike, që do të shoqërohen me më shumë thatësirë. Kjo shifër mund të përkeqësohet nëse deri në 2036-ën vendi nuk investon 9.8 miliardë dollarë. Dy sektorët më të rrezikuar nga ndryshimet klimatike janë bujqësia dhe turizmi

Ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale pritet të sjellin temperatura ekstreme të larta edhe më të shpeshta në Shqipëri në 10-vjeçarin

infrastruktura me cilësi të ulët, ndërtimet e pakontrolluara dhe një sërë faktorësh mjedisorë të ndikuar nga njeriu, që nga shpyllëzimi i shpejtë, menax-



e ardhshëm, duke e shtuar rrezikun për zjarre, por nga ana tjetër edhe reshjet intensive të papritura që shtojnë përmbytjet.

Në ‘Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036’ të hartuar nga ministria e Mjedisit thuhet se klima kërcënon komunitetet dhe infrastrukturën, ndaj duhen masa urgjente në disa sektorë të ekonomisë, nga bujqësia, turizmi, transporti, energjia apo zhvillimi urban, në të kundërt Shqipëria mund të humbasë 7% të Prodhimit Kombëtar nga mos-reagimi në kohë.

“Cenueshmëria e popullsisë shqiptare ndaj fatkeqësive natyrore përkeqësohet nga varfëria,

himi i dobët i baseneve ujore, degradimi në rritje i tokës e deri te ndotja mjedimore”, thuhet në planin e ministrisë.

Për të parandaluar humbje në përmasa të tilla, nevojiten investime 9.8 miliardë dollarë, në sisteme kullimi, argjinatura, rezervuarë, teknologji mbrojtëse ndaj ngjarjeve ekstreme, apo në ngritje të sistemeve të informacioni.

Po ashtu do të investohet në ripyllëzim në shkallë të gjerë, në ngritjen e planeve të emergjencave, gjelbërimin urban, rivendosjen e një brezi të gjelbër përgjatë bregdetit për të mbrojtur tokën nga erozioni apo investime në mbrojtjen e infrastrukturës energjetike apo përmirësimin e operacioneve

të hidrocentraleve.

Këto investime thuhet në dokument janë të domosdoshme pasi Shqipëria ka humbur 2.3 miliardë dollarë në 3 dekada prej fatkeqësive natyrore. Fatkeqësia më e afërt është ajo e tërmetit të nëntorit 2019, me 51 viktima dhe 200 mijë banorë të prekur, e me kontribut negativ në ekonomi me 7.5%.

Sektorët më të rrezikuar nga ndryshimet klimatike janë bujqësia dhe turizmi. Sipas planit sektori bujqësor që është kryesor në ekonominë e vendit mund të përballlet me rënie të prodhimit, tkurrje të tokave të mbjella e mungesë vaditje.

Po kështu edhe turizmi bregdetar, atraksioni kryesor në vend, është ekspozuar ndaj përmbytjeve dhe erozionit të plazheve, ndërsa ndryshimet në modelet e temperaturës dhe reshjeve mund të ndikojnë edhe turizmin malor. Ndaj propozohet diversifikim i ofertës turistike drejt turizmit historik apo kulturor.

“Ekonomia është e ndjeshme ndaj kushteve të pafavorshme të vazhdueshme të motit, të cilat mund të ndikojnë veçanërisht te grupet e marginalizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta, që shpenzojnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre për produkte të domosdoshme”, thuhet në dokument.

Salla: Po punojmë për mbylljen e çarjes së argjinaturës së Devollit

Strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me bashkinë e Devollit dhe Forcat e Armatosura, po punojnë pa ndërprerje për të mbyllur çarjen e krijuar në argjinaturën e lumit Devoll, e shkaktuar nga prurjet e shumta të ditëve të fundit.

Për të mundur mbërritjen e mjeteve dhe materialeve inerte deri në pikën e dëmtuar, po ndërtohet një rrugë e përkohshme me gjatësi 3,2 kilometra.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, së bashku me prefektin, Nertil Jole, kryetarin e bashkisë, Gëzim Topçiu, zëvendësministrin Arjan Jaupllari dhe drejtorin e UK Korçë, Gentian Aliçkolli, inspektuan zonën e Sheqerasit, ku ekipet e DUK Korçë po punojnë për rehabilitimin e çarjes në argjinaturën e lumit Devoll.

Ministri Salla bëri të ditur se ngritja e pritës provizore



ka ndalur depërtimin e ujit në Fushën e Maliqit dhe ka krijuar kushtet që, gjatë këtyre ditëve pa reshje, uji të tërhiqet nëpërmjet rrjetit kullues, ndërsa vijohet me mbylljen përfundimtare të argjinaturës.

“Prioritet absolut mbetet mbyllja e çarjes për të shmanjur çdo përmbytje të mundshme. Ekipet janë në gatishmëri të plotë dhe puna po zhvillohet

me intensitet maksimal, 24 orë në 24. Çdo orë që fitojmë është e rëndësishme për sigurinë e zonës përpara reshjeve të radhës”, deklaroi ministri Salla gjatë inspektimit.

Në zonën e prekur janë shtuar mjetet e rënda dhe kapacitetet logjistike, ndërsa po vendosen masivisht gurë dhe materiale të tjera mbushëse për të garantuar stabilizimin e argjinaturës.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FINANCIM

Tregu i shoqërive të kursim-kreditit në rritje vjetore

Tregu i shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) ka shënuar rritje dyshifrore për nëntë muajt e parë të këtij viti. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, totali i aktiveve të tregut në fund të shtatorit arriti

këtij sektori ngelet modeste në raport me segmentet e tjera të tregut financiar dhe kryesisht me sektorin bankar. Asetet e

fokus kryesor financimin e ekonomive bujqësore. Ato pranojnë depozita nga anëtarët dhe ofrojnë kredi për ta, duke pasur si qëllim kryesisht mbushjen e boshllëkut që krijon mungesa e pranishë së sektorit bankar në zonat rurale dhe periferike të vendit. Ky model ka rezultuar veçanërisht efikas për ofrimin e shërbimeve financiare në zonat që kanë akses të kufizuar në sektorin bankar.

Aktiviteti ndërmjetësues i SHKK-ve mbështetet, në pjesën më të madhe, te depozitat e anëtarëve. Në shtator të këtij viti, depozitat përbënin afërsisht 64% të detyrimeve totale të sektorit. Në vlerë ato prekën shifrën e 12.15 miliardë lekëve, në rritje 7.1% me bazë vjetore.

Edhe në sektorin e SHKK-ve në dy vitet e fundit po vërehet një rritje e peshës së depozitave në valutë të huaj. Depozitat në valutë janë në rritje vjetore 10%, pavarësisht

efektit negative të kursit të këmbimit, duke qenë se bilanci raportohet në Lekë. Ndërsa depozitat në monedhën vendase shënuan një rritje të ulët, me 6% krahasuar me shtatorin e vitit të kaluar. Pësia e depozitave në valutë ndaj totalit ka arritur në 23%, nga 22.4% që kishte qenë një vit më parë.

Në përgjithësi, SHKK-të ofrojnë norma interesi për depozitat më të larta se bankat tregtare, ndërsa paralelisht edhe kreditë në përgjithësi kanë norma më të larta interesi.

Rritja e depozitave të SHKK-ve vitet e fundit është mbështetur shumë edhe nga përfshirja e tyre në skemën e sigurimit të depozitave. Që prej vitit 2017, depozitat pranë SHKK-ve janë të siguruara deri në vlerën e dy milionë lekëve.

Por, siguri bën efekt vetëm në momentin kur SHKK-ja përkatëse anëtarësohet në skemën e sigurimit të Agjencisë së Sigurimit të

Depozitave. Për këtë qëllim, SHKK-të duhet të certifikohen dhe të marrin një vërtetim të përmbushjes së kriterëve nga Këshilli Drejtues i ASD-së. Agjencia e Sigurimit të Depozitave raporton nëntë subjekte të anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave.

Portofoli i kredisë të dhënë

nga SHKK-të në fundin e 9-mujorit të këtij viti arriti në pothuajse 14 miliardë lekë, me rritje prej 7.1% që nga fillimi i vitit dhe 9% krahasuar me një vit më parë.

Pjesa tjetër e aktiveve konsiston kryesisht në depozita të vendosura në institucione të tjera financiare, ndërsa një pjesë shumë të vogël zënë investimet në letrat me vlerë dhe aktivet jo financiare.




vlerën e 19 miliardë lekëve ose pothuajse 197 milionë eurove.

Vlera e aktiveve të tregut është rritur me 10.7% që nga fillimi i vitit dhe me 12.5% krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

Megjithatë, madhësia e

SHKK-ve përbëjnë afërsisht 0.9% të totalit të aktiveve të sistemit bankar në vend.

Shoqëritë e kursim-kreditit ose kooperativat financiare janë një segment i mikrofinancës veçanërisht i suksesshëm në zonat rurale të vendit, me



Rritet varësia nga importet e ushqimeve, 1.4 miliardë euro në 10-mujor

Ekonomia e vendit tonë harxhoi për blerjen e ushqimeve jashtë një shumë prej 135 miliardë lekësh (1.4 miliardë

i brendshëm nuk po mbulon zgjerimin e konsumit për ushqime.

Të dhënat tregojnë një zgjer-

shënuar grupi kafe, çaj dhe erëza, ku importet janë rritur me 38%, duke reflektuar rritje të çmimeve globale dhe zgjerim të konsumit të brendshëm.

Po ashtu, rritje të ndjeshme kanë pësuar edhe frutat dhe arrat e ngrënë (+11.6%), produktet bulmetore dhe vezët (+12.2%), si dhe ushqimet e përgatitura prej mishi, peshku e molusqeve (+14.3%). Shtesë e fortë vërehet edhe te kakao dhe produktet e saj (+10%).

Në total, importet e produkteve ushqimore u rritën me 3 miliardë lekë (rreth 30 milionë euro), krahasuar me vitin 2024, duke konfirmuar se Shqipëria mbetet një treg që e mbështet konsumin ushqimor kryesisht te furnizimet e importuara.

Importet e ushqimeve në vlerë po rriten për dy arsye kryesore: rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare për disa artikuj të tillë si kafeja

dhe kakao, dhe nga ana tjetër rritja e konsumit, e nxitur nga turistët.

Në 10-mujorin 2025, importet e ushqimeve ishin tre herë më të larta se eksportet e këtij grupi. Varësia e lartë ndaj importeve të ushqimeve e bën vendin më të ndjeshëm ndaj çmimeve globale, luhatjeve të kursit të këmbimit dhe çrregullimeve të zinxhirëve të furnizimit.

Importet më të larta ulin konkurrencën dhe motivimin për të prodhuar brenda vendit. Një tjetër pasojë është zgjerimi i deficitit tregtar.

Siguria ushqimore gjithashtu cenohet, pasi ndërprerjet në furnizim mund të sjellin mungesë të produkteve bazë dhe rritje të çmimeve, ndërsa kontrolli i cilësisë bëhet më i vështirë për shkak të volumit të madh të importeve.

Fermerët mendojnë se

zgjerimi i prodhimit bujqësor vjen duke aplikuar stimuj fiskalë dhe politika mbështetëse për prodhuesit vendas, përfshirë subvencione për teknologji, kredi me normë të ulët interesi dhe trajnime për menaxhim modern të bujqësisë. Kjo ndihmon prodhuesit

të jenë më konkurrues dhe të qëndrueshëm.

Shqipëria nuk ka ende koordinim institucional dhe politika të planifikimit strategjik, për të identifikuar prioritetet në prodhimin ushqimor, menaxhimin e tregut dhe monitorimin e importeve.




euro) në 10-mujorin 2025, me rritje 3.4% në krahasim me të njëjtin periudhë të 2024.

Nga ana tjetër, megjithëse ka një rritje të eksporteve, shifrat tregojnë se prodhimi

im të konsumit, çmime më të larta në tregjet ndërkombëtare dhe një varësi të qëndrueshme nga importet për kategoritë kryesore të ushqimeve.

Rritjen më të fortë e ka



Bido: Sulm i padrejtë ndaj mandarinave të Konispolit, dëmshpërblejmë fermerët për përmbytjet

Deputeti i Partisë Socialiste, Ardit Bido, deklaroi se mandarinat e Konispolit janë përbalhur me një sulm të orkestruar mediatisht, që ka çuar në uljen e çmimit për fermerët, ndërsa në tregjet e qyteteve arrijn mbi 100 lekë për kilogram.

Sipas tij, ky është një sulm që vjen prej grosistëve të cilët duan të sjellin mandarina të importuara dhe organizojnë sulme mediatisht.

“Në asnjë rast nuk ka asnjë analizë që të nxjerrë mandarinat e Konispolit me pesticide. Dua të falënderoj Ministrinë e Bujqësisë për praninë gjatë javës së kaluar në Konispol, e cila e ngriti këtë çështje dhe e deklaroi pub-

likisht. Besoj se është çasti që ne të veprojmë në shërbim të këtyre njerëzve punëtorë, të një zone që prodhon sasinë më të madhe të mandarinave për tregun shqiptar, i prodhon me cilësi dhe punon gjithë vitin për këto ditë. Duhet të veprojmë përmes organeve shtetërore, duke deklaruar publikisht të vërtetën e madhe se ky është një sulm i padrejtë ndaj fermerëve”, tha Bido.

Deputeti theksoi nevojën e masave për mbrojtjen e prodhimit vendas.

“Ndoshta ka ardhur çasti që për produktet që janë të subvencionuara në vendet e tjera me vlera shumë herë më

të mëdha se subvencionimet që vijnë te ne dhe rrjedhimisht nuk përbëjnë tregti të lirë nga ato që rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë përcaktojnë, ne të vendosim traun në doganë, në mënyrë që të mund të shitet produkti vendas në këtë kohë”, deklaroi Bido.

Bido u ndal edhe te situata e përmbytjeve, që ka prekur zona të ndryshme, përfshirë Sarandën, Delvinën dhe Konispolin, duke shkaktuar dëme të mëdha në tokat bujqësore, shtëpi, blegtori dhe bletari.

“Pa dyshim do të dëmshpërblehen fermerët dhe bizneset e dëmtuara”, tha ai.

Jaupaj: Kapitulli për mjedisin, hapa të qëndrueshëm drejt afrimit me standardet europiane

Ministri Mjedisit, Sofjan Jaupaj mori pjesë në takim me grupin ndërshtetëror të punës për integrimin europian, mbledhje e mbajtur në një moment vendimtar për Kapitullin 27 – Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike, ku po ecet me ritme intensive drejt përmbushjes së piketave mbyllëse.

“Pozicioni i përbashkët me Bashkimin Europian është dorëzuar, duke na dhënë një panoramë të qartë të kërkesave dhe afateve që duhet të adresojmë, ndërsa ky takim shërbeu edhe si përgatitje për takimet treditore me Komisionin Europian, ku do të finalizoj-

het Plani i Veprimit për Piketat Mbyllëse, një dokument kyç që përfshin të gjithë acquis të Kapitullit 27”, nënvizoi Jaupaj.

Ministri Jaupaj u shpreh se “Kapitulli 27 është një nga më të kërkuarit e procesit të integrit, por me punën e përbashkët të institucioneve përgjegjëse dhe me projektet që tashmë kemi në zbatim, po hedhim hapa të qëndrueshëm drejt afrimit me standardet europiane”.

Politika e mjedisit e BE-së synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mbrojtë mjedisin për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.

Ajo bazohet në masat parandaluese, në parimin “ndotësi paguan”, duke luftuar dëmtimin e mjedisit në burim, në përgjegjësinë e përbashkët dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së.


Acquis përfshin mbi 200 akte kryesore ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rreziqeve, kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ), zhurmën dhe pylltarinë.

INTEGRIM

Bizneset shqiptare në bujqësi dhe tekstile: Drejt tregut të BE - UNIDO dhe qeveria suedeze mbështesin transformimin e gjelbër

Bizneset shqiptare në sektorin e tekstilit, këpucëve dhe bujqësisë përballen me sfida në rritje: kosto në rritje, kërkesa më të rrepta të qëndrueshmërisë evropiane, ulje të porositjeve dhe presion për të konkurruar në tregun ndërkombëtar. Për të mbijetuar dhe për të lulëzuar, kompanitë duhet të inovojnë, modernizohen dhe të adoptojnë prak-

ritje të fitimeve. Nga 800 euro që paguaja për energjinë të 300 eurot, ajo diferencë prej



tika më të gjelbra. “Eficienca e Burimeve dhe Prodhimi më i Pastër (RECP), program që po zbatohet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial, UNIDO, me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, i ndihmon bizneset të ulin konsumin e energjisë, materialeve, ujit dhe kimikateve, të minimizojnë mbetjet dhe të adoptojnë praktika qarkore. Rritja e produktivitetit është një avantazh konkurrues. Përtej metodologjisë, kjo ka të bëjë me ndërtimin e një ekonomie më të gjelbër – gati për të përmbushur standardet evropiane, për të hyrë në tregjet e eksportit dhe për të konkurruar globalisht.”

Presidenti i ProExport Albania, Edvin Prençe, shprehet se aplikimi i masave RECP ka ndihmuar në reduktimin e ndjeshëm të faturave të energjisë elektrike.

“Sigurisht, ka pasur humbje të ndjeshme. Po ju jap shembullin tim konkret: vitet e mëparshme paguaja rreth 800 euro në muaj për energjinë elektrike, ndërsa sot, si e njëjta biznes me pothuaj të njëjtin numër punonjësish, paguaj mesatarisht 350–400 euro në muaj. Ky reduktim i kostos ka ardhur falë investimeve që kam bërë në makineri inovative dhe të reja. Ky është shembulli më konkret, përtej fokusit të përgjithshëm të sektorit, por e përmend shembullin tim personal sepse është diçka që edhe të tjerët kanë filluar ta zbatojnë — ashtu siç kanë nisur të investojnë në panele diellore dhe metoda të tjera për të kompensuar kostot në rritje dhe shpenzimet e panevojshme që hasim. Është një nga efektet më pozitive. Nga ana tjetër, duke marrë si shembull CAD/CAM, ka shumë biznese që nuk kanë një metodologji të digjitalizuar të prodhimit, dhe kur puna bëhet manualisht, është e pashmangshme që të ketë mbetje më të larta dhe skrap teknologjik të shtuar. Duke mundësuar trajnime përmes CAD/CAM dhe çdo trajnimi tjetër të nevojshëm, garantoj që shumë biznese do të përjetojnë ulje të mbetjeve dhe

500 eurosh më lejon që, kur paraqes një ofertë për klientin, ta reflektoj direkt këtë kursim në çmimin final. Dhe pikërisht këtu fillon çdo nismë dhe çdo ofertë — nga analiza e burimeve njerëzore, identifikimi i asaj që mund të kursehet dhe çfarë mbetjesh mund të eliminohen, për të mbetur konkurrues sot dhe nesër në tregun evropian”, thekson Prençe.

Bizneset në sektorin agrobujqësor gjithashtu po ndjejnë përfitimet nga ky projekt, duke i bërë ato më konkurruese dhe më të gatshme për tregun e vetëm evropian.

“Së pari duhet t’i kushtojmë vëmendje përpunimit të mbetjeve në sektorin bujqësor. Flas për mbetjet blegtorale, për mbetjet e peshkimit, për mbetjet bujqësore. Po flas gjithashtu për mbetje që dalin nga grumbullimi i produkteve dhe nga bujtinat e ndryshme, nga mbetjet ushqimore — të gjitha këto mund të riciklohen dhe mund të prodhojmë pleh organik dhe ekologjik. Sot Shqipëria ka një nevojë të pamohueshme për më shumë pleh organik për të prodhuar produkte organike dhe me cilësi të lartë. Kemi rreth një milion ton mbetje në sektorin agro-ushqimor, të cilat mund të përdoren për të prodhuar gjithë sasinë e plehut organik që na nevojitet dhe të eliminonjmë importin e tij — qoftë për arsye kostoje apo cilësie. Kjo është një nga rrugët e riciklimit që na intereson dhe duhet zhvilluar më tej. Nëse duam të reduktojmë kimiketet, insekticidet dhe pesticidet, natyrisht cilësia do të rritet dhe do të afrohem me shumë me tregjet evropiane. Riciklimi është një nga mënyrat më efikase për ta arritur këtë proces, sidomos për cilësinë dhe standardet, që janë burimi ynë kryesor i të ardhurave dhe rezervave. Po përmend shembullin e vajit të ullirit. Shqipëria prodhon rreth 30,000 ton vaj ulliri në vit dhe e ka shitur të gjithë, pa diferencim cilësie, me 3.5 euro, duke arritur rreth 105 milionë euro. Nëse vetëm 10,000 ton — vaji

ekstra i virgjër, me cilësi të lartë — do të shitej me çmimin e tij mesatar prej 10 eurosh, kjo do të përbënte 100 milionë. Pra, vetëm ato 10,000 ton janë rezerva më e madhe që kemi në aspektin e cilësisë. UNIDO po punon fort në këtë drejtim që kjo të adoptohet nga agrobiznesi dhe të zbatohet sa më gjerë, sepse përmes cilësisë fitojmë më shumë sesa përmes sasisë. Inovacioni është instrumenti përmes të cilit agrobiznesi do të përballojë sfidat e kushteve të këqija atmosferike, konkurrencën e pandershme, do të përmbushë kërkesat e tregut të BE-së për produkte cilësore, do të menaxhojë kostot e larta që kemi sot — dhe të gjitha këto mjete dhe modele të reja që po përdorim na bindin se inovacioni dhe digjitalizimi janë instrumentet më të dobishme që duhet t’i përdorim pa hezitim”, shprehet Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar.

Ndërsa kompanitë e tekstilit, theksojnë se kursimi i energjisë vlerësohet të jetë në nivelin 30 %.

“Tani që qëndrueshmëria është bërë një kërkesë shumë më thelbësore për të gjitha bizneset dhe klientët me të cilët punojmë, ajo nuk është më vetëm trend, por një grup kërkesash të rrepta që duhet të përmbushen. Prandaj e kemi marrë shumë seriozisht dhe kemi nisur iniciativë të rëndësishme.

Kemi një plan qëndrueshmërie — një plan vjetor që përcakton ku jemi dhe si përmirësohemi vit pas viti. Kështu, ky projekt që realizuam së bashku na ndihmon të identifikojmë të gjithë makineritë, pajisjet ose proceset ku mund të kursejmë energji dhe ujë. Dhe sigurisht, duke i përmirësuar këto, përmirësojmë performancën tonë të qëndrueshmërisë, që është një avantazh shumë i rëndësishëm konkurrues sot.

Do të mund të përmirësojmë rezultatet e gjurmës së karbonit për këpucët që prodhojmë. Ky është një tregues konkret dhe i matshëm që mund të përmirësohet vit pas viti. Sipas llogaritjeve paraprake në planin tonë të veprimit, presim të kursejmë deri në 30% energji deri në vitin 2026. Sa i përket ujit, mendojmë se përmirësimet do të jenë rreth 12–15%, pasi nuk e përdorim ujin aq shumë sa energjinë. Pra, ka hapësirë për përmirësim, por në nivele disi më të ulëta krahasuar me energjinë”, shprehet Etleva Laro, Administrator e “Prodyn”.

Për ekspertët e zbatimit të projektit në Shqipëri, aplikimi i këtyre masave nga bizneset është i domosdoshëm për uljen e kostove dhe menaxhimin e mbetjeve.

“Besoj se ky është momenti i duhur për kompanitë — në fakt ka vite që është, por tani është

bërë thelbësor — që kompanitë të zbatojnë masat RECP. Së pari, sepse ato përballen me kosto të larta të energjisë, të cilat po bëhen shumë të vështira për t’u përballuar. Së dyti, kostot e menaxhimit të mbetjeve janë në rritje dhe kompanitë duhet t’i heqin ato pavarësisht. Së treti, kompanitë po përballen me kosto të larta për shkak të luhatjeve të euros, që i shtyn të gjejnë mënyra për t’u bërë më efikase dhe për të ulur kostot e prodhimit, për të menaxhuar sfidat në rritje. Prandaj mendoj se ky është momenti më i mirë për kompanitë që të marrin seriozisht RECP, të kuptojnë si të jenë më efikase me energjinë, menaxhimin e mbetjeve, ujin dhe çdo gjë tjetër brenda operacioneve të tyre, në mënyrë që të ulin kostot dhe të sigurojnë përfitime më të mëdha në fund të ditës. Së dyti, kjo i përgatit ata për tregun e ri përpara — një treg që në të ardhmen do të ketë gjithnjë e më shumë nevojë dhe kërkesa të tilla. Besoj se këto masa nuk janë thjesht detyrime; ato përgatisin kompanitë për llojin e klientit që nesër, në Europë, do të kërkojë standarde që ato duhet t’i përmbushin. Këto masa shërbejnë si një lloj testi për kompanitë, duke i aftësuar të përballen me klientë të rinj dhe të jenë gati të mbeten konkurruese në treg — sepse nuk duhet harruar se kompani të tjera dhe vende të tjera kanë avancuar dhe janë bërë efikase shumë përpara nesh”, thekson Françeska Korançe, Lehtësuese e Klubit RECP në Shqipëri.

Ndërsa nga përfaqësuesit e kompanive që operojnë në sektorin agro-bujqësor vihet theksi tek domosdoshmëria për të përqafuar digjitalizimin dhe inovacionin me qëllim arrijtjen e standardeve të BE-së dhe hyrjen në tregun e vetëm evropian.

“Projekte si ato të UNIDO-s e kanë ndihmuar sektorin bujqësor ta shohë situatën nga një perspektivë tjetër nga ajo e bujqësisë intensive që kemi qenë mësuar. Shqipëria tani po ndryshon; po largohemi nga bujqësia primitive dhe po kalojmë drejt bujqësisë së integruar. Pjesë e kësaj është dixhitalizimi dhe mekanizimi në fermë, sepse sot këto janë domosdoshmëri, jo më inovacion si disa vite më parë. Ky është i vetmi mënyrë për të tërhequr të rinjtë drejt punës, i vetmi mënyrë për të parë drejt një të ardhmeje të qëndrueshme, dhe sigurisht është i leverdishëm nëse i kombinojmë të gjitha këto komponentë — sepse prodhojmë dhe shesim me çmime më të larta në vendet evropiane. Jo vetëm kaq, por sigurojmë standarde të qëndrueshme për vite. Mund të sigurojmë kontrata afatgjata. Shumë kompani kanë qenë

pionierë të këtyre praktikave të mira, të cilat fermerët me siguri do t’i ndjekin, sepse nuk ka mënyrë tjetër për të punuar. Pa certifikim dhe pa standarde, nuk mund të presim të shesim me çmime më të larta. E rëndësishme është që fermerët, për të shitur, duhet të dinë çmimin dhe të kenë një çmim të qëndrueshëm dhe të drejtë. Pavarësisht nëse na pëlqen apo jo, si eksportues jemi nën vëzhgim të vazhdueshëm — si nga klientët tanë ashtu edhe nga trupat e certifikimit që na auditojnë. Dhe kjo tregon qartë se duhet t’i zbatojmë këto praktika më gjerësisht — jo vetëm në kompanitë tona, por edhe në fermë — sepse aty nisin produkti i qëndrueshëm, produkti me mbetje të kontrolluara; aty mund të flasim me të vërtetë për bujqësi të integruar. Bujqësia e integruar nuk do të thotë që nuk përdorim pesticide, por që respektojmë afatet e tërheqjes dhe mbajmë kontroll mbi pesticidet — duke siguruar që ato të jenë të lejuara, jo të ndaluara, në Bashkimin Evropian, të cilin mezi presim t’i bashkohemi. Prandaj të gjitha këto praktika vijnë si rezultat i certifikimeve që ndëtojmë jo vetëm brenda kompanive tona, por edhe duke i zbatuar në prodhimin e fermave”, nënvizon Besnik Koçi, President i “BioBes”.

Në Austri dhe vende të tjera, kompanitë që zbatojnë praktikën RECP arrijnë ulje të ndjeshme kostosh, përmirësuan efikasitetin dhe pozicionimin e tyre në treg. Këto përvoja ofrojnë mësim të vlefshme për Shqipërinë ndërsa kërkon të rrisë konkurrueshmërinë, të adoptojë prodhim më të gjelbër dhe të hyjë në tregjet e BE-së.”

Tashmë edhe në kurrikulat akademike është përfshirë një program i dedikuar për eficientë të burimeve dhe prodhimin më të pastër.

“Ne, si institucion i arsimit të lartë, jemi të vetmit që mbulojmë sektorin e tekstilit me kurrikulë akademike, aktivitete kërkimore, punë shkencore dhe ekspertizë. Ofron dy programe studimi — Bachelor dhe Master Shkencor — dhe jemi gjithashtu pjesë e programit të ciklit të tretë, Shkollës Doktorale në materialet tekstile. Punohet fort për të qëndruar të përditësuar me zhvillimet teknologjike, si dhe me rregulloret, procedurat dhe konceptet e reja si qëndrueshmëria, menaxhimi i burimeve dhe prodhimi i pastër, sipërmarrja, inovacioni dhe digjitalizimi. Në këtë kontekst, bëjmë një përpjekje të fortë për të përditësuar kurrikulën, jo vetëm përmes literaturës që u rekomandojmë studentëve, por edhe duke futur module të reja. Rreth dy vite më parë, futëm dy module

të reja në programin Bachelor: një me titull “Menaxhimi i Burimeve dhe Prodhimi i Pastër,” i lidhur me RECP, dhe i dyti “Sipërmarrja dhe Start-up-et,” që na ndihmojnë të ecim me ritmin e zhvillimeve të reja. Kemi një program të gjatë praktike — rreth nëntë javë për studentët Bachelor dhe Master — dhe ky afat u mundëson studentëve të mësojnë dhe të vënë në praktikë atë që kanë studiuar, si dhe të ndërveprojnë me bizneset duke ndarë njohuri të reja për qëndrueshmërinë e produktit, proceset e prodhimit dhe ekonominë rrethore. Në këtë mënyrë, akademika dhe institucionet e arsimit të lartë veprojnë si forcë kryesore nxitëse drejt transformimit, praktikave të ekonomisë qarkore dhe prodhimit të qëndrueshëm. Kapaciteti i departamentit është rritur përmes trajnimeve dhe ekspertizës që ekspertët ndërkombëtarë kanë ofruar për ekspertët dhe stafin tonë të brendshëm. Këta pjesëtarë të stafit janë të përfshirë drejtpërdrejt me kompanitë vendase të prodhimit të tekstileve dhe këpucëve në zbatimin e masave RECP të rekomanduara nga ekspertët. Po ashtu, gjetjet dhe rezultatet e projektit integrohen në kurrikulë dhe planet e studimit, dhe më pas u transmetohen studentëve, pasi i konsiderojmë forcën e ardhshme të tregut të punës — jo vetëm në vend por edhe ndërkombëtarisht”, shprehet Prof. Ermira Shehi, Eksperte Kurrikule (UPT).

Në optikën e Ministrisë së Bujqësisë, produktet shqiptare do të hyjnë në tregun evropian vetëm nëse kanë cilësi të lartë dhe për këtë, inovacioni është çelësi.

“Agrobujqësia dhe agro-përpunimi shqiptar duhet të hyjnë në Bashkimin Evropian me produkte me cilësi të lartë. Me fjalë të tjera, elementi thelbësor i produkteve shqiptare duhet të jetë cilësia. Produkti duhet të ketë ndikim të ulët mjedisor dhe të përdorë në mënyrë efikase burimet; duhet të plotësojë prirshmëritë e konsumatorit evropian të sotëm.

Rruga jonë nuk do të fokusohet vetëm te përmbushja e kërkesave minimale të Tregut të Përbashkët të BE-së, por të shkojë më tej — duke zhvilluar produkte që ruajnë vlerë të shtuar në sytë e konsumatorit, gjë që natyrisht përkthehet në çmime më të larta për tregtarët dhe për prodhuesit në të gjithë vendin. Ndodhemi në një udhëkryq thelbësor për bizneset tona. Jemi në një pikë ku duhet — jo thjesht të ecim, jo thjesht të vrapojmë — por të rendim, dhe ta bëjmë këtë shumë shpejt. Duhet të rrisim këto standarde minimale për produktet bujqësore dhe të përpunuara, në mënyrë që deri në vitin 2030 të mund të hyjmë realisht në tregun e Bashkimit Evropian me mallrat tona. Nuk kemi kohë për të humbur. Përkundrazi, duhet të lëvizim me shpejtësi në këtë drejtim, sepse është e vetmja rrugë që përcakton

INTEGRIM

(Vijon nga faqja 11)

të ardhmen e bizneseve tona dhe të ardhmen e produkteve shqiptare në tregun e përbashkët të Europës. Çdo formë mbështetjeje që marrim në këtë drejtim është jashtëzakonisht e rëndësishme. Këtu përfshihet edhe ndihma e siguruar nga UNIDO me mbështetjen e Ambasadës Suedeze. ‘Bizneset e zgjuara’ janë para së gjithash biznese që kanë një qasje më të drejtpërdrejtë ndaj inovacionit. Duke marrë parasysh kushtet aktuale të ekonomisë shqiptare, inovacioni duhet të jetë parimi kyç që udhëheq funksionimin e bizneseve tona”, thekson Fatmir Guri, Zëvendësministër i Bujqësisë.

Qeveria sudeze mbështet Shqipërinë drejt prodhimit të gjelbër dhe transformimit të bizneseve shqiptare në këtë drejtim, si kusht edhe për anëtarësimin në Bashkimin European.

“Do të thoja se ka disa arsye. Njëra është e dukshme: duhet të mendojmë për klimën

Bizneset shqiptare në bujqësi dhe tekstile: Drejt tregut të BE - UNIDO dhe qeveria suedeze mbështesin transformimin e gjelbër

dhe mjedisin në nivel global dhe ndërkombëtar. E dyta është se, përmes angazhimeve tona ndërkombëtare për të ulur emetimet e CO2 dhe për të përmirësuar kushtet klimatike, kemi objektiva që duhen përbushur, dhe kjo vlen edhe për Shqipërinë. Industria prodhuese krijon shumë CO2, emetime dhe ndotje që prekin ajrin dhe ujin, prandaj industria duhet të bëhet më e gjelbër dhe më efiçente. Në Shqipëri, rreth 30% e emetimeve të CO2 vijnë nga industria, pra është një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së vendit që ndot, dhe për këtë arsye duhet ta bëjmë më të gjelbër.

Pra, kjo lidhet me objektivat e klimës dhe mjedisit, por është gjithashtu ekonomi e zgjuar për bizneset dhe vendin. Nëse

e bëjmë prodhimin më të gjelbër, besoj se kompanitë mund të kursejnë para; zakonisht ulen kostot, gjë që është e mirë për bizneset dhe për vendin. Jam i lumtur që Suedia — ne bashkëpunojmë me UNIDO-n në këtë temë pasi kompanitë tona janë lidere globale dhe vendi ynë është një lider global për klimën dhe mjedisin — dhe është e natyrshme që jemi të angazhuar.

Jam i kënaqur me programin që kemi me UNIDO-n. Shqipëria ka disa iniciativa të mira drejt prodhimit më të gjelbër, por duhet bërë më shumë, dhe qasja duhet të jetë më sistematike si për vendin, ashtu edhe për kompanitë.

Nëse merrni Suedinë si shembull, është një avantazh konkurrues për kompanitë

suedeze që ato mund të thonë me bindje se funksionojnë sipas standardeve klimatike, përmirësojnë klimën, përmirësojnë efiçencën e energjisë dhe janë kompani me përgjegjësi mjedisore. Ato gjithashtu respektojnë rregullat e punës dhe mjedisit të punës.

Kjo është një përparësi konkurruese, prandaj u sjell atyre përfitime ekonomike. Nëse Shqipëria dhe kompanitë shqiptare bëhen më të gjelbra, ato do të jenë partnerë më të besueshëm për kompanitë ndërkombëtare — si për investime në Shqipëri, ashtu edhe për të lehtësuar eksportin e produkteve shqiptare, nëse mund të garantojnë se janë prodhuar me metoda miqësore me mjedisin.

Kjo do të ndihmojë industrinë tuaj të eksportit dhe investimet e huaja. Dhe për njerëzit, është normale të shqetësohen se industria dhe sektorë të tjerë krijojnë emetime dhe ndotin ajrin. Ndonjëherë kemi probleme me këtë në disa qytete shqiptare si dhe me ujin, dhe mendoj se të gjithë do të përfitonin nga ajri dhe uji më i pastër.

Pra, është gjithashtu një aspekt shëndeti dhe mirëqenieje. Prodhimi i gjelbër mund të jetë i mirë për biznesin për sa i përket kursimit të kostove, por është gjithashtu një fushë ku mund të fitohen para nga riciklimi, ripërdorimi, shpikja ose adaptioni i teknologjive të reja. Pra, është edhe një mundësi biznesi. Duhet të them gjithashtu se ky vend dëshiron të anëtarësohet

në BE, dhe ka kërkesa që duhen përbushur për prodhimin e gjelbër, riciklimin, menaxhimin e mbetjeve dhe gjithçka tjetër në këtë fushë. Pra, nëse dëshironi të hyni në BE, duhet të përmirësoheni në këtë drejtim, që është një arsye e madhe dhe e rëndësishme”, shprehet Sh.T.Z. Niklas Strom, Ambasador i Suedisë në Tiranë.

